



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 2 paragrafi 2.2 dhe 39. 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nenit 19 të Statutit të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.09.2003, mori

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 2 ndryshohet dhe thotë:

2.1 Subjekti afarist që ushtron veprimtarinë në komunën e Prishtinës, duhet të jetë i regjistruar sipas **Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2001/6 për shoqëritë tregtare** dhe në bazë të **urdhëresave, udhëzimeve** të tjera të lëshuara nga **UNMIK-u** dhe **Kuvendi i Komunës së Prishtinës**.

NENI 3 ndryshohet dhe thotë:

3.1 Certifikata e regjistrimit të subjekteve afariste në pajtim me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2001/6, urdhëresat dhe udhëzimet tjera.

3.2.1 Subjektet afariste, të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi apo leje shndërrimi nga lokali banesor në atë afarist, në të cilin e ushtrojnë veprimtarinë, u ipet leja e punës **me kusht** që brenda një viti të sigurojnë lejen përkatëse. Nëse edhe pas kalimit të këtij afati nuk e sigurojnë lejen përkatëse, e njehta nuk do të vazhdohet.

II. DISPOZITAT NDËRSHKUESE

NENI 9 ndryshohet dhe thotë:

9.1 Të gjitha subjektet të cilat nuk do të respektojnë afatin e dhënë nga personi i autorizuar për sigurimin e lejes për punë, do të denohen për kundervajtje:

- **Personat juridik..** **200 deri 300 Euro**
- **Personat fizikë**.....**100 deri 200 Euro**

9.2 Të gjitha subjektet të cilat nuk bëjnë ripërtërirjen e lejës për punë në afatin e dhënë në nenin 5, do të denohen për kundërvajtje:

- **Personat juridik**.....**200 deri 300 Euro**
- **Personat fizikë**.....**100 deri 200 Euro**

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 12 ndryshohet dhe thotë:

12.1 Pas fjalës punë, në afatin e dhënë nga personi i autorizuar.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati i Ekonomisë dhe Drejtorati i Inspektionit.

V. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr. _____ Data _____

**KRYETAR I KUVENDIT
ISMET BEQIRI**